



**Oda e Stomatologëve të Kosovës**  
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të OSK-së  
Anëtarët e Këshillit Drejtues të OSK-së  
Anëtarësinë e OSK-së  
Anëtarët e Komisioneve të përhershme dhe Organeve tjera të OSK-së  
Shërbimin profesional të OSK-së

**Nga:** Prof. Dr. Blerim Kamberi, Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës

**Lënda:** Qarkore informative lidhur me funksionimin e OSK-së, gjatë periudhës së zbatimit të masave mbrojtëse, të bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 01/09 të datës 13.03.2020

**Datë:** 16 Mars 2020.

Të nderuar,

Bazuar në nenin 20, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë Nr. 04/L-150, dhe në nenin 23, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, Kryetari i OSK-së lëshon këtë:

**Qarkore Informative lidhur me funksionimin e OSK-së për ditët në vijim, respektivisht deri në zbatimin e masave të përkohshme**

Nga data 17 Mars 2020 Oda e Stomatologëve të Kosovës do të funksionojë si në vijim:

- Pezullohen të gjitha mbledhjet në takime fizike të të gjitha organeve të OSK-së, deri në përfundimin e zbatimit të masave mbrojtëse të rekomanduara nga Qeveria e Kosovës.
- Pezullohen të gjitha procedurat që janë duke u zhvilluar pranë OSK-së, dhe afatet e tyre nuk do të rrjedhin deri sa të pushojë zbatimi i masave mbrojtëse të rekomanduara nga Qeveria e Kosovës.

- Pezullohet puna me palë pranë selisë së OSK-së, pasi që zyret e selisë së OSK-së do të jenë të mbyllura. Të gjitha shërbimet e mundshme për anëtarët e OSK-së (shkarkimi i formularëve, dorëzimi i dokumenteve të skenuara, e të ngjashme), bëhen përmes **faqes së internetit të OSK-së ([www.osk-ks.org](http://www.osk-ks.org))**, dhe dorëzohen përmes **postës zyrtare elektronike të OSK-së ([info@osk-ks.org](mailto:info@osk-ks.org))**.
- Udhëzohen anëtarët e OSK-së, që gjatë orarit të rregullt të punës për çdo informatë shtesë të kontaktojnë me zyrtarët kujdestarë në numrin e telefonit zyrtar të OSK-së si në vijim: **+383 (0) 45 240 588**, dhe emaili zyrtar [info@osk-ks.org](mailto:info@osk-ks.org).